# Protokoll Nr 10

Ky protokoll mbahet sot me dt. 24.10.2025 në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë Divjakë lidhur me zhvillimin e mbledhjes së rradhës për muajin ... Tetor 2025.

Në mbledhje morën pjesë keshilltorët:

Lili Biti, Ardian Vodo, Tatjana Budom
Donika Stose, Alketa Gonaku,
Juljan Gapi, Shpetim Meshi,
Elmeina Sina, Xhorxhi Kruti
Indrit Zgjani, Ajete Mebelli,
Gerjort Agolli, Elda Simoni, Jurgen Suli
Rozo Broshku, Majlinda Xhoro
Bido Dermyshi, Mishel Verdha
Sahit Ibrahimaj, Seit Kajo,
Sokol Kaloshi, Lili Biti, Adelajda Culi.

Megjithëse u plotësua kuorumi i nr të këshilltorëve në mbledhje Kryetarja e deklaron mbledhjen të hapur me këtë rend dite.

1. Miratimi i rendit të ditës.
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes që u zhvillua në datë 26.9.2025.
3. Informacion mbi zbatimin e VKB për m. Tetor.
4. Projektvendim për miratimin e familjeve që do të trajtohen nga fondi i kushtëzuar deri 6% për bllokun ndihmës për m. Tetor 2025.
5. Projektvendim për miratimin e përfundimit të procedurës së privatizimit të banesave të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në ASHK.
6. Projektvendim mbi akordimin e ndihmës financiare për familjen e z. Denis Tafti.
7. Projektvendim për mbulimin e tarifës së ushqimit të kopështit me drekë nga Bashkia Divjakë për fëmijën e z. Sandi Bendo.
8. Projektvendim për miratimin e projektit "Rishikim i projektit të ujitjes me presion për skemën e ujitjes Divjakë.
9. Relacion nga DFB - mbi monitorimin

Project: Date ...... / ...... / ...........

e zbatimit të buxhetit për periudhën Janar - Gusht 2025.

1. Pika e parë e rendit të ditës.

- Miratimi i rendit të ditës.

Znj. Xiri Biti i drejtohet këshilltarëve:
A keni pyetje, shtesë, diskutime për rendin e ditës?

Merr fjalën zv. kryetari i këshillit z. Indrit Zejno, ku propozon shtesë në rendin e ditës pr. vendimin Nr. 73 prot me nr 10716/16 dt. 22.10.2025 "Të dhënie mandati këshilltares znj. Roza Troshku, dhe propozon që kjo shtesë të jetë në pikën e dytë të rendit të ditës në [illegible].

Pyetje, diskutime, shtesë të tjera s'ka.

Hidhet në votim pika e parë e rendit të ditës dhe votohet me 22 vota pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim së bashku me shtesën e propozuar.

2. Pika e dytë e rendit të ditës.

- Të dhënie mandati këshilltares znj. Roza Troshku.

Kryetarja i jep fjalën për të lexuar raportin e mbajtur nga Komisioni i verifikimit të mandateve sekretares së këtij komisioni znj. Fotjona Budani. znj. Fotjona Budani i propozon këshilltarëve që në këtë mbledhje të miratojë dhënien e mandatit znj. Roza Sulejman Troshku.

Pyetje s'ka, diskutime s'ka.

Hidhet në votim pika e dytë e rendit të ditës dhe votohet me 22 vota pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim. Pas miratimit të dhënies së mandatit këshilltares znj. Roza Troshku betohet: "Betohem në nderin tim se do të kryej me ndërgjegje detyrën e anëtarit të KB Divjakë dhe do ti bindem kushtetutës e ligjeve. Betohem se në të gjithë veprimtarinë time do të udhëhiqem nga interesat e shtetasve të Bashkisë Divjakë dhe do të punoj me ndershmëri e përkushtim për zhvillimin dhe rritjen e mirëqenies së tyre." Kalohet në pikën e tretë të r. ditës.

3. Pika e tretë e rendit të ditës

- Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së dt. 26.09.2025.
Diskutime s'ka, diskutime s'ka.
Hidhet në votim pika e tretë e rendit të ditës dhe votohet me 22 votë pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.

4- Pika e katërt e rendit të ditës.
- Informacion mbi zbatimin e vendimeve të KB për muajin Shtator 2025.
Tjetër s'ka, diskutime s'ka nga këshilltarët.
Kryetarja z.nj. Liri Biti ia jep fjalën për relatim Kryetarëve të komisioneve për Raportet mbi shqyrtimin e Projektvendimeve.
Raportin e shqyrtimit të projektvendimeve nga Komisioni i Ekonomisë dhe financave e lexon z. Gjon Apolli duke u shprehur se Komisioni i shqyrtoi projektvendimet dhe vendosi që të kalojnë për miratim në mbledhje por me kushtin që Projektvendimi nr 70 dt. 14.10.2025 të plotësohet me bazën ligjore për emergjencat civile.
z. Shpëtim Shestani lexon Raportin e Komisionit të bujqësisë, pyjeve, emergj. civile dhe shprehet se Komisioni në mbledhjen e tij për shqyrtimin e projektvendimit për miratimin e projektit "Rikonstruksioni i projektit të ujitjes me presion për skemën e ujitjes Divjakë, vendosi që të kalojë për miratim në këtë mbledhje.

5. Pika e pestë e rendit të ditës
- Për miratimin e familjeve që do të trajtohen nga fondi i kushtëzuar deri 6% për bllok ndihmën për muajin shtator 2025.
Kryetarja ia jep fjalën për relatim z. Ledio Kuco ku i propozon këshilltarëve që të miratojnë për muajin shtator 2025, 14 familje për ndihme ekonomike me një fond prej 65418 lekë.
Tjetër s'ka, diskutime s'ka.
Hidhet në votim pika e pestë e rendit të ditës dhe votohet me 22 votë pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.

6. Pika e gjashtë e rendit të ditës.
- Për miratimin e përfundimit të procedurës së privatizimit të banesave, të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në ASHK prej Dushnje për lidhjen e kontratave para noterit. Erdhi znj. Eldia Sinani.
Relatori z. Andi Ballori ku i shprehet këshilltarëve se kanë aplikuar për përfundimin e procedurës së privatizimit të banesave 4 familje, por gjatë kësaj kohe kemi dhe një familje tjetër e cila ka aplikuar më dt. 21.10.2025 dhe propozoj që të miratoni në këtë mbledhje 5 familje aplikante të cilat i përmendim një nga një 1. z. Xhevdet Gjata, 2. z. Idriz Cyse, 3 - z. Altin Ruçi 4 - z. Nun Manika, 5 - z. Thanas Shuti.
Kryetarja znj. Xin Biti i drejtohet këshilltarëve: A kemi pyetje apo diskutime?
Pyetje s'ka, diskutime s'ka.
Hidhet në votim pika e gjashtë e rendit të ditës dhe votohet me 23 vota pro, asnjë votë kundër, dhe asnjë votë abstenim për 5 (pesë) familje aplikante.

7. Pika e shtatë e rendit të ditës.
- Mbi akordimin e ndihmës financiare për familjen e z. Denis Prifti.
Në këtë kohë erdhi këshilltari Eugen Verdha.
Kryetarja znj. Xin Biti ia jep fjalën për relatim specialistit të emergjencave civile z. Feit Dosja, i cili i propozon këshilltarëve që të miratojnë akordimin e ndihmës financiare për familjen e z. Denis Prifti nga fondi rezervë në vlerën 100 000 lekë. Kjo vjen si rezultat i dëmit të shkaktuar nga përmbytja e sipërfaqes së mbjellë me kulturën lakër koke. Komisioni i konstatimit të dëmit e vlerson me 240000 lekë, por ligji nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile" si dhe VKM nr. 329 dt. 16.5.2019 i jep të drejtën Bashkisë deri në 100000 lekë.
Kryetarja znj. Xin Biti: A kemi pyetje?

znj. Alketa Canaku: Çeisoni në fjalë është i shpenzuar?
z. Ardjan Vodo: Procesverbali i konstatimit është me vlerën 240000 lekë? Pse nuk ia japim komplet dëmin e shkaktuar? Nuk kemi të drejtë që qytetarin ta ndihmojmë?
z. Sahit Ibrahimaj: Sipas ligjit për emergjencat civile Këshilli Bashkiak ka të drejtë deri në 100000 lekë.
Pyetje të tjera s'ka, diskutime s'ka.
Hidhet në votim pika e shtatë e rendit të ditës dhe votohet me 24 votë pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.
8. Pika e tetë e rendit të ditës.
- Për mbulimin e tarifës së ushqimit të kopështit me oferte nga Bashkia Divjakë për femijën e z. Dondi Bendo.
Për këtë pikë relatoi specialistja e arsimit znj. Nevilda Ndoni, ku i propozoi Këshilltarëve që familjes së z. Dondi Bendo, ti mbulohet tarifa e ushqimit të femijës që ka në kopështin me drekë në fshatin Germë Sektor, për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike e sociale, ku z. Dondi Bendo trajtohet me kemp dhe veiberi, dhe bashkëshortja trajtohet me kemp për aftësi të kufizuara mendore të moderuara. Prandaj duke u nisur nga kjo gjendje e kësaj familje Bashkia ti mbulojë tarifën e ushqimit të femijës në kopështin Germë Sektor.
Pyetje s'ka, diskutime s'ka
Hidhet në votim pika e tetë e rendit të ditës dhe votohet me 24 votë pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.
9. Pika e nëntë e rendit të ditës.
- Për miratimin e projektit "Rishikim i Projektit të ujitjes me presion për skemën e ujitjes Divjakë.
z. Andi Bulloni lexon projektvendimin e përgatitur nga Bashkia dhe i propozon këshilltarëve

Project: Date ...... / ...... / ..........

të miratojnë projektin "Rishikim i projektit të ujitjes me presion për skemën e ujitjes Divjakë.

Kryetarja znj. Lin Biti: Ako pyetje apo diskutime në lidhje me pikën e nëntë të rendit të ditës.

z. Ardian Dodo: Ju lutemi na e sqaroni më saktë dhe qartë përse shërben ky projekt?

Përgjigjet Drejtori i Bujqësisë z. Dhimitër Jordi: Ky projekt do të mbulojë zonën e Divjakës me ujitjen e tokave, sqaron hortet e shtrirjes së tubave të ujitjes si dhe vendi ku do të merret uji i cili do të ujë me presion gjatë dy rrugëve kryesore dhe tubat do të shtrihen në kanalet e treta.

z. Gëzim Agolli: Ky projekt është vazhdim i projektit të parë? Po projekti i parë a është funksional?

z. Sabit Ibrahimaj: Këtë projektvendim a e ka shqyrtuar komisioni i urbanistikës, duhet të kalojë njëherë tek komisioni i urbanistikës.

Përgjigjet znj. Lin Biti: Po, ka kaluar nga komisioni i bujqësisë, mjedisit dhe emergjencave civile. Raportin e komisionit e lexoi z. Shpetim Shesha.

z. Eugen Vendha: Sikur se të gjitha këto projekte janë pa firmë dhe nuk është bashkangjitur preventivi me vlerën e saktë. Derisa nuk funksionon faza e parë e këtij projekti me këtë sistem ujitje, pra nuk ka dhënë rezultat, përse ta rrealizojmë fazën e dytë? Përgjigjet me replikë z. Shpetim Shesha.

z. Eugen Vendha, Këto investime janë me vlerë të mëdha dhe nuk mund ti kalojmë këto projekte pa projekte me firmë dhe preventivin bashkangjitur.

z. Sabit Ibrahimaj: Unë mendoj se ky

projekt vendim duhet të meret në shqyrtim nga Komisioni i Urbanistikës dhe pikë të votë kundër.
z. Shpëtim Sheshi: Nëse duhet të kalojë edhe nga Komisioni i Urbanistikës të mblidhemi bashkë e ta shqyrtojmë. Ndërhyn dhe z. Stavri Xhoxo, teknike në sektorin e ujitjes duke sqaruar projektin.
z. Eugen Verdhie: Për projektin e ujitjes me presion për Bujqësinë kërkojmë 1- të vijnë specialistë ing. nga Drej Ministria e Bujqësisë, të na e sqarojnë këtë projekt: a do të jetë funksional apo jo dhe të bashkopunësim dhe parandalimin sa është vlera e këtij investimi. 2- Të vijë në mbledhje një përfaqësues nga Banka Botërore dhe ta mbrojë këtë projekt që ne ta miratojmë. Projekti të niset Komisionit të urbanistikës me email. Pasi të meret përgjigje nga Banka Botërore dhe Ministria e Bujqësisë Kryetari i Bashkisë të kërkoj mbledhje jashtë radhe.
Kryetarja znj. Xin Biti, Meqënëse nuk kemi pyetje dhe diskutime të tjera hedhim në votim pikën e nëntë të rendit të ditës.
Hidhet në votim pika e nëntë e rendit të ditës dhe votohet me 9 vota kundra 5 vota abstenim dhe 10 këshilltorë nuk votuan. Ky projekt vendim nuk miratohet.

10. Pika e dhjetë e rendit të ditës.
- Mbi monitorimin e zbatimit të buxhetit për periudhën Janar - Gusht 2025.

Për këtë pikë relatoi Përgjegjëse e sektorit të financës dhe buxhetit znj. Irena Gjoni duke prezantuar realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit për periudhën 8 mujore, si dhe duke vënë në dukje një realizim të mirë në drejtim të grumbullimit të të ardhurave dhe realizimit të investimeve të planifikuara për këtë periudhë. Pyetje dhe diskutime nga këshilltorët nuk kemi.
Kryetarja znj. Xin Biti i drejtohet këshilltorëve. Pikat e rendit të ditës i realizuam, tani kalojmë në zerin:

të tjera. Kryetorja i a jep fjalën këshilltarit z. Sohit Ibrahimaj. Tek kanali i madh, tek kanali që kalon midis Ushtarit Ferros - Meitish, kanë filluar që të ngordhin shumë peshq. A jemi në dijeni?
Përgjigjet Drejtori i Bujqësisë, mjedisit e pyjeve z. Dh. Kruti.
z- Jashtë kopështit Ferros janë hedhur në kosha mbetjet këto kosha janë tejmbushur dhe gjithë ambienti është bërë i padurueshëm, ku ndikon në jetën dhe shëndetin e fëmijëve. Sot mungon Drejtori e shërbimeve komunale por duhet të merrni masa për pastrimin e këtyre mbetjeve dhe plehrave, është shumë emergjente dhe koshat të dezinfektohen me klor.
3- Problematike është edhe kur bie shi, gropat e rrugëve të shtruara me çakull mbushen me ujë. Do sistemohen duke pastruar ujin e të bëhet mbushja e tyre.
znj. Dolnika Stosa: Kërkojmë një informacion të detajuar për punimet në shkollën Remos, se po hasim shumë vështirësi si në koridore dhe terreni jashtë është plot me mbetje dhe i papastruar.
z. Sohit Ibrahimaj: Kërkojmë që në çdo mbledhje të vijnë Drejtorët e Drejtorive për të na sqaruar të gjitha problematikat që shtrojmë në komunitetin.
z. Eugen Vendhe: Kemi shumë probleme që shtrojmë, i kemi kërkuar dhe asnjë nuk po është zgjidhur. Kam mendimin që të gjithë Drejtorët dhe përgjegjësit të vijnë në mbledhje dhe të na japin zgjidhje për problematikat që shtrojmë. Çdo problem që shtrojmë në mbledhje të protokollohet dhe përgjigjet të na kthehen me shkrim.
znj. Elda Sinani: Na kam shqetësimin nga ekipi i sportit të Cemit sektorit. A ka afat për përfundimin e fushës së sportit, kemi dy muaj dhe shikojmë njëherë fillojnë punimet, pastaj lihen pas dore. Kur do të përfundojë fusha e sportit në C. Sektor.
z. Tek rruga kryesore Cemit Sektor, jo vetëm që duhet rregulluar nga gropat, por duhen vendosur 2-3 police të shtruara se kalojnë mak. me shpejtësi?

Project: Date ...... / ...... / ..........

3. Tek shkolla Çermë sektor kemi nevojë për një punonjës sigurie. A është e mundur të na delegohet një polic nga Bashkia?

Çështje e problematike të tjera nuk ka.

Kryetarja znj. Lini Biti e deklaron mbledhjen të mbyllur.

Procesverbali u mbajt nga Sekretari i Këshillit të Bashkisë Divjakë.

Sekretari i KB

Mimoza Ofeniaj

Kryetari i KB

Lini Bitë

Indrit Zejjoma

Ilirjan Vrep

Saimir Haraliaj

Elmerina Lina

Fatjona Dedaj

SEIT VRAP

Donika Stasa

Elda Simoni

Gëzim Agalliu

Mishel Verdha

Alketa Çaushi

Bido Desmyari

Majlinda Xhani

Dargen Shehi

Roza Troshku

Sokol Koloshi

Ajete Meselli

Adelajda Çulaj

Eugen Verdha